



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPIAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 18 dhe 20 të Ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 03 prill 2019, Rregullores (QRK) nr. 09 /2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i dates 24.12.2021 , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.02.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE

Neni 1 Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Imri Semetishti nga ekzekutivi i Komunës,
2. Bekim Shabani nga ekzekutivi i Komunës
3. Rinor Murati nga subjekti politik LDK
4. Arsim Jashari nga subjekti politik PDK
5. Ferdian Shala –OJQ “YADR”, nga sektori joqeveritar lokal

Neni 2 Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit të ankesave është dy (2) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

Neni 3 Detyrat e Komisionit

Komisioni i ankesave shqyrton ankesat e palëve të pakënaqura nga procesi i vlerësimit të ofertave nga komisioni vlerësues, konform procedurave të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr. 06/I-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregullores (QRK) nr. 09 /2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës .

Komisioni bën shqyrtimin e ankesave brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike

Neni 4 Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj , Rregulloren e cekur dhe me këtë vendim do ti ndihmojë Zyra Kryetarit të Komunës - Sektori pronësor - juridik.

Neni 5 Kompensimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për shqyrtimin e të gjitha ankesave që kanë të bëjnë me procedurën e zbatimit të një ankandi përkatësisht një konkursi, do të kompenzohen në lartësinë e një kompensimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kompensimi do të bëhet vetëm për anëtarët e komisionit të cilët nuk e kanë të ndaluar kompensimin për kryerjen e shërbimeve shtesë konform dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe akteve tjera nënligjore me të cilat rregullohet kjo çështje nëse të njëjtat nuk bien në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 6 Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr. 15-020/04-11341

Lipjan, më 28.02. 2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

